



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË”

Tiranë, më 29.12.2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

<u>Nr.</u>	<u>Përmbatja</u>	<u>Faqe</u>
I-	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-7
II-	HYRJA	7-10
	a. Objektivat dhe qëllimi	7-8
	b. Identifikimi i çështjes	8-8
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
	d. Përgjegjësitë e audituesve	8-9
	e. Kriteret e vlerësimit	9-9
	f. Standardet e auditimit	9-10
III-	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10-11
IV-	GJETJET DHE REKOMANDIMET	11-34
	Drejtimi 1 , i Programit të Auditimit	11-16
	<i>-Auditim mbi veprimtarinë e Qendrës për Trajnimin e Administratës Tatimore dhe Doganore, planifikimi dhe zbatimimi i programit të trajnimeve sipas fushave.</i>	
	Drejtimi 2 , i Programit të Auditimit	16-23
	<i>-Auditim mbi hartimin dhe zbatimimin e buxhetit, rregullshmëria e zbatimit të kuadrit rregullator ligjor në shpenzimet për paga dhe shpërblime, shpenzime operative dhe shpenzime të tjera</i>	
	Drejtimi 3 , i Programit të Auditimit	23-24
	<i>-Auditim mbi kriteret e vendosura dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e trajnuesve të përhershëm dhe atyre me kohë të pjesëshme vendas dhe të huaj.</i>	
	Drejtimi 4 , i Programit të Auditimit	24-29
	<i>-Vlerësimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm.</i>	
	Drejtimi 5 , i Programit të Auditimit	29-34
	<i>-Të ndryshme</i>	
V-	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	34-36



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore për periudhën 01.01.2015 deri më 31.10.2017, e cila në qendër të veprimtarisë së saj ka formimin profesional të administratës tatimore dhe doganore në periudhën e provës, zhvillimin e karrierës, përshtatjen profesionale me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta, etj. Auditimi u përqëndrua në 4 (katër) drejtime kryesore të përcaktuara gjatë fazës së planifikimit paraprak dhe konkluzionet rreth tyre paraqiten në mënyrë të detajuar në pjesën e 4 (katërt) të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi. Në këtë auditim u angazhuan tre auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky subjekt nuk rezulton të jetë audituar më parë nga KLSH, por sipas programit të auditimit nr. 5340/1 datë 08.02.2015 rezulton të jetë audituar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Krijimi dhe funksionimi i Qendrës për Trajnimin e Administratës Tatimore dhe Doganore mbështetet në VKM Nr.1264 datë 16.12.2009. Struktura e saj është e përcaktuar së fundi me Urdhrin e Kryeministrit Nr.44 datë 10.02.2014 “Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.105 ” duke strukturuar një administratë prej 9 punonjësish. Sipas kësaj strukture ekziston mungesa e dy pozicioneve Specialist të Drejtorisë së Programeve, pjesë e stafit të trajnuesve të përhershëm të Qendrës për të cilët QTATD ka kryer detyrimin për njoftim pranë DAP nëpërmjet Formularit të raportimit mujor por këto pozicione pune ende vijojnë të jenë vakante. Konstatohet se trajneret *part-time* nuk mund të paguhen prej QTATD, pasi kjo qendër funksionon në përputhje me Ligjin e Nëpunësit Civil dhe është institucion buxhetor me strukturë të miratuar, dhe si e tillë nuk mund të lidhë kontrata punësimi me trajnerë të jashtëm dhe as t’i deklarojë ata si të punësuar pranë saj, problematikë e cila kërkon një përcaktim të ri ligjor dhe që nuk mund të garantohet nga VKM nr.1264.

Gjatë periudhës 01.01.2015-31.10.2017, konstatohet mungesa vendimmarrjeve të Bordit Drejtues sipas përcaktimeve ligjore në VKM Nr.1264 datë 16.12.2009 pika 4), për përcaktimin e programet e trajnimit, miratimin e tarifave, si dhe vendimmarrjeve të tjera të rëndësishme për mirëfunksionimin e kësaj qendre. Pavarësisht kësaj, QTATD ka vijuar workshop-et, seminarët dhe trajnimet e kërkuara prej Administratës Tatimore dhe Doganore sipas rastit. Kërkesat për trajnimin e punonjësve të rinj apo dhe atyre për formimin e vazhdueshëm janë miratuar prej drejtuesve të institucioneve Tatimore dhe Doganore, të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të bordit drejtues të QTATD. Konkretisht rezultojnë të jenë trajnuar në total 5,372 punonjës fiskalë, prej të cilëve punonjësit e administratës tatimore zënë 70% të numrit të përgjithshëm ose 3,760 punonjës ndërsa punonjësit e trajnuar të administratës doganore janë 1,612 punonjës dhe zënë 30% të numrit total të të trajnuarve. Konstatohet DPT dhe DPD kanë në strukturat e tyre sektor të veçantë për trajnimet krahas veprimtarisë trajnuese të qendrës, për të cilat duhet të bëhet një rishikim i përgjithshëm për eliminimin e ekzistencës së strukturave të dyfishta që sjellin si pasojë kosto shtesë për buxhetin e shtetit. KLSH gjykon si domosdoshmëri rishikimin e përgjithshëm të bazës ligjore mbi të cilën ushtron veprimtarinë QTATD-ja, si në përcaktimin e qartë të organizimit dhe funksionimit, kompetencave të këtij institucioni publik me natyrë specifike fiskale, por dhe për rishikimin e në tërësi të mënyrës së funksionimit, rekrutimit të lektorëve, financimit, etj, si dhe nevojës që baza ligjore e saj të jetë në harmoni me misionin e qendrës, por edhe me aktet e tjera ligjore në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës publike dhe formimin profesional të punonjësve publikë. Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin, mbajtjen e kontabilitetit, dhënia e opinionit për nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit public në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë QTATD.

Në përfundim të procedurës audituese për përmirësimin e situatës të konstatuar u rekomandua -Një Propozim për Ndryshime apo Përmirësime në Legjislacion dhe Një Masë Organizative.

Në përfundim të fazës së Raportit Përfundimtar të Auditimit u konstatuan problematika të cilat u përmbledhën në gjetje dhe rekomandime të klasifikuara sa më poshtë :

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
1	<p>Mbi veprimtarinë e QTATD. Nga auditimi mbi përputhshmërinë e organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së QTATD me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike rezultoi se;</p> <p>- VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” ka përcaktuar se QTATD drejtohet nga një Bord Drejtues megjithëse ky është një institucion në varësi të Ministrisë të Financave. Kjo formë organizimi nuk mbështetet në Ligjin Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore” i cili në nenin 18 përcakton se “<i>Institucioni i varësisë organizohet si drejtori apo drejtori e përgjithshme, në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë përkatëse. Niveli i organizimit përcaktohet në vendimin e krijimit</i>”. Po kështu forma e organizimit me Bord Drejtues sipas VKM nr.1264 nuk i përshtatet as formës së organizimit të një Agjencie Autonome, e cila duhet të bëhet me ligj dhe jo me VKM si në rastin konkret.</p> <p>Në VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” përcaktohet se;</p> <p>- “Trajnuesit e Përhershëm” sipas përcaktimit në pikën 9, nuk kryejnë veprimtari trajnuese megjithëse në emërtimin e tyre trajtohen si të tillë. Detyra e tyre e përcaktuar në VKM ekzistuese është të sigurojnë mbështetjen për organizimin e trajnimeve, monitorimin, plotësimin, dhe vlerësimin e rezultateve të trajnimit për çdo</p>	<p>Drejtimi nr. 1 “Auditim mbi veprimtarinë e Qendrës për Trajnimin e Administratës Tatimore dhe Doganore”</p> <p>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p>	E lartë	Ministria e Financave si organ që ka në varësi këtë Qendër, të rishikojë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtrohen aktivitetet trajnuese me qëllim, qartësimin dhe saktësimin e fushës së veprimtarisë së tyre si dhe harmonizimin me kuadrin e përgjithshëm ligjor në fuqi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

<p>nëpunës. Emërtimi dhe detyrat e punonjësve të brendshëm të qendrës të emërtuar “<i>Trajnues të Përhershëm</i>” kërkojnë kapacitete profesionale të një niveli të lartë të cilat duhet të jenë mirëpërcaktuar në bazën ligjore, në mënyrë që të mos jenë të prekshme nga vendimmarrje të një niveli më të ulët.</p> <p>- Baza rregullative parashikon edhe “<i>Trajnuesit part-time</i>” të cilët ndryshe nga punonjësit e përhershëm dhe punonjësit administrativë me të cilët përcaktohet lidhja e kontratës së punës sipas pikës 8/dh dhe 8/ë, pikën 10 të saj, përcaktohet termi kontraktim “<i>Trajnuesit e kontraktuar me kontrata part-time...</i>” duke i kthyer këta trajnerë në staf që duhet të deklarohen nga qendra si të punësuar dhe për të cilët duhet të derdhen edhe sigurime shoqërore, fakt që e rrit koston në nivele të paparashikuara. Ky përcaktim ka bërë që QTATD të përfshijë në procesin trajnues vetëm trajnerë të marrë nga administrata tatimore dhe doganore pjesë të administratës publike dhe që e kanë kryer këtë mision pa pagesë shtesë.</p> <p>Nga ana tjetër në kriteret e përgjithshme për kontraktimin e “<i>Trajnuesve part-time</i>” sipas 10/b të VKM përcaktohet dhe rasti që këta trajnerë të jenë të punësuar në poste drejtuese në administratën publike me përvojë të paktën 5-vjeçare. Kriteret të lidhura me funksionet dhe jo kapacitetet e personave që përfshihen për trajnerë, ul nivelin e trajnimeve dhe krijon rrishtje operationale për sa kohë vlerësimi i trajnimit ndikon në vlerësimin e punonjësit tatimor apo doganor.</p> <p>- VKM nr.1264 datë 16.12.2009 përcakton se “<i>Punonjësit në periudhe prove, të cilët nuk kalojnë provimin e vlerësimit të organizuar pranë Akademisë, nuk konfirmohen për përfundimin me sukses të periudhës së provës</i>” aspekt që ka një rregullim tjetër në bazë të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” sipas të cilit Shkolla Shqiptare e Administratës Publik (ASPA) është institucioni që duhet të realizojë vlerësimin e nëpunësit civil për periudhën e provës pas përfundimit të ciklit të detyrueshëm të trajnimit.</p> <p>- Megjithatë ngarkesën më të madhe të trajnimeve të administratës tatimore dhe doganore i realizon kjo qendër, konstatohet se brenda strukturave të</p>			
--	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

	Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka një sektor të veçantë për trajnimin e punonjësve. Duhet të theksojmë se Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore e cila në fokusin e veprimtarisë së saj ka pikërisht trajnimin e administratës fiskale, ka anëtarë të Bordit Drejtues Titullarët e këtyre 2-Drejtorive, çka tregon qartë mosfunksionimin e duhur të niveleve drejtuese të këtyre institucioneve në drejtimin e personelit, për sa kohë që konstatohen kosto shtesë për buxhetin e shtetit.			
2	Planifikim buxhetor afatmesëm dhe përfundimtar nuk pasqyron aktivitetin real të institucionit. Nga auditimi i procedurave të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të Qendrës së Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore rezultoi se për periudhën objekt auditimi, shpenzimet e realizuara nga institucioni ishin dukshëm më të ulëta se planifikimi i tyre, për shkak të mungesës së koordinimit me strukturën administrative të Ministrisë së Financave për kryerjen e procedurave përkatëse për blerjen e mallrave, dhe mos plotësimin të pozicioneve vakante nga ana e Departamentit të Administratës Publike. Po kështu, konstatohet në vitin 2017, pas largimit nga puna të nënpunësës zbatuese të institucionit, ky funksion kryhet nga nënpunësi zbatues i Ministrisë së Financave.	Drejtimi 2: “Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, rregullshmëria e zbatimit të kuadrit ligjor në shpenzimet për paga dhe shpenzime shpërblime, shpenzime operative dhe shpenzime të tjera” <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 16-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E Mesme	1.1-Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore të marrë masa që në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të kryejnë zbatimin në afat të shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara në përputhje me aktivitetin e institucionit, për të realizuar kështu përdorimin efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit në sektorët prioritarë. 1.2- Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave të kryejnë vlerësimin për ekzistencën e konfliktit të interesit në kryerjen e funksionit të nëpunësit zbatues për dy institucionet, përkatësisht Ministrisë së Financave dhe QTADT, si njësi vartësie e saj.

Konkluzione dhe Opinioni I Auditimit

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000¹). Nga auditimi mbi përputhshmërinë², për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet aktiviteti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Qendrën e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, janë konstatuar aspekte jofunksionale të lidhura me kuadrin ligjor rregullator të tejkaluar në kohë dhe mospërshtatjen e tij me ndryshimet që kanë

¹ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

² Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”.

³ISSAI 4000 - 4200 - Audituesi shpreh një konkluzion të kualifikuar kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

ndodhur në mjedisin ku ushtron veprimtarinë kjo qendër. Është konstatuar mosfunksionimi për një kohë të gjatë i Bordit Drejtues pavarësisht përpjekjeve konstante dhe pozitive të Drejtorit të QTATD, duke penguar realizimin e plotë të qëllimit për të cilin është krijuar kjo qendër me natyrë unike. Auditimi i Përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, për shkak të mospërputhjeve të konstatuara me kuadrin ligjor dhe rregullator (*kriteret*), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, konkludon me dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë***³.

Në Opinionin tonë, subjekti Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, përveç mangësive të identifikuar që ndikojnë në nivelin e plotësimit të qëllimit të veprimtarisë së saj, ka plotësuar nevojat për trajnim të identifikuar nga administrata fiskale, tatimore dhe doganore.

II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1143/1 prot datë 16.11.2017, nga data 16.11.2017 deri në date 27.11.2017, për periudhën nga 01.01.2015 deri në 31.10.2017 me lloj auditimi “Auditim i Përputhshmërisë” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1- K.Xh.
- 2- J. T.
- 3- E. Ll.

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin, dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë “Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”.

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

Objektivat e auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi: Nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

financiar dhe kontrollin. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

Identifikimi i çështjes:

Auditimi në Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore për periudhën në auditim Janar 2015-Tetor 2017 u krye sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e auditimit. Lidhur me aktivitetin dhe QTATD ka vijuar veprimtarinë me trajnimin në total të 5,372 punonjës fiskalë. Për këtë janë dakordësuar kalendarët e trajnimit me administratat dhe trajnerët përkatës pjesë e këtyre administratave. Nga auditimi u evidentuan mospërputhje midis përcaktimeve në VKM nr. 1264 me akte të tjera ligjore të cilat rregullojnë mënyrën e organizimit, funksionimit të administratës publike dhe mardhëniet në shërbimin civil. Konstatohet mungesa e vendimmarrje të nevojshme prej Bordit Drejtues si për aktivitetin e qendrës, ashtu edhe për adresimin e problematikave. Nga auditimi mbi Zbatimin i buxhetit, rregullshmëria në kryerjen e shpenzimeve u konstatua një planifikim më i lartë i fondeve krahasuar me realizimin faktik të tyre, u konstatua që nuk janë marrë shërbime nga trajnerë të jashtëm si rrjedhojë e paqartësisë ligjore. Për këto problematika dhe jo vetëm, nga ana jonë gjykohet nevoja për rishikimin e të gjithë bazës ligjore mbi të cilën organizohet dhe funksionon qendra.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:

-Drejtori i QTATD është përgjegjës për zbatimin e detyrave funksionale të përcaktuara në VKM Nr.1264 datë 16.12.2009, Statutin e QTATD dhe Rregulloren e Brendshme të miratuara me Vendimin e Bordit Nr.1 datë 23.04.2013, Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” I ndryshuar, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar dhe aktet të tjera ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e njësisë publike.

Drejtori i qendrës për vitin 2015, 2016 dhe Janar-Tetor 2017 ka qenë në funksionin e Nënpunësit autorizues.

-Specialist i Financës (*Nëpunësi zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Në vitin 2017, pas largimit të znj. A. O., e cila ishte nëpunëse zbatuese e institucionit, në vijim të shkresës nr. 65, datë 10.05.2017, të QTADT nëpunës zbatues i përkohshëm është vendosur znj. R. N., nëpunëse zbatuese e Ministrisë së Financave.

-Personeli i QTATD detyrat funksionale i ka të përcaktuara, në VKM Nr.1264 datë 16.12.2009, Statutin e QTATD dhe Rregulloren e Brendshme të miratuara me Vendimin e Bordit Nr.1 datë 23.04.2013.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar

-Të vlerësojë nëse informacioni mbi çështjen në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi dhe në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*), të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë se transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që ne si auditues t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për përputhshmërinë e veprimeve të ndjekura nga subjekti i audituar në përputhje me kuadrin ligjor.

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

- VKM Nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e qendrës së trajnimit të administratës tatimore dhe doganore”

-Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999 “Per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe Enteve Publike”.

-Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore në funksion të tyre.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

- Ligji Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”.

-Të tjera akte ligjore dhe nënligjore rregullative.

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, ISSAI 4000-4200 për dhënien e opinionit, dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Testet e kontrolleve të përdorur gjatë veprimtarisë audituese konsistojnë në:

1-Kontrolli aritmetik që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

2-Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

3-Kontrolli i vlerësimit për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat eparaqitura në pasyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4-Verifikimi i transaksioneve duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

5-Intervistimi i personelit që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.

6-Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit.

7-Pyetsorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në lidhje me informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore e emërtuar Akademia Fiskale është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Financave e cila në qendër të veprimtarisë së saj ka formimin profesional të administratës tatimore dhe doganore a) në periudhën e provës b) për zhvillimin e karrierës c) për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës, sipas ligjeve të fushës ç) me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta d) për zhvillimin e njohurive profesionale. Misioni kryesor i QTATD është edukimi fillestar dhe sistematik i punonjësve të administratës tatimore dhe doganore me qëllim arritjen e objektivave strategjike të përgjithshme qeverisëse dhe ato specifike të organeve fiskale në përputhje me rregullat dhe dispozitat ligjore të tjerave në fuqi në RSH. Krijimi dhe funksionimi i kësaj qendre mbështetet në VKM Nr.1264 datë 16.12.2009 në të cilën janë përcaktuar, forma e organizimit dhe funksionimit, fusha e veprimit, vendimmarrja, mënyra e financimit etj.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit

Objekt i këtij auditimi është “Auditimi i Përputhshmërisë” të aktivitetit për subjektin Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.10.2017. Qëllimi i auditimit në “Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

shëndoshë financiar si dhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 4100, ISSAI 4000 dhe ISSAI 1315)³, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Fushëveprimi i auditimit ka qënë auditimi i veprimtarisë së kësaj qendre në planifikimin dhe zbatimin e programit të trajnimeve sipas fushave përkatëse, rregullshmërinë e hartimit dhe zbatimit të buxhetit, rregullshmërinë e zbatimit të kuadrit ligjor për paga, shpërblime, shpenzime operative, mbi kriteret e ndjekura për trajnerët part-time, mjedisin e kontrollit të brendshëm etj.

IV- GJETJET DHE REKOMANDIMET

➤ Drejtimi 1: “Auditim mbi veprimtarinë e Qendrës për Trajnimin e Administratës Tatimore dhe Doganore”

I- Krijimi dhe funksionimi i Qendrës për Trajnimin e Administratës Tatimore dhe Doganore mbështetet në VKM Nr.1264 datë 16.12.2009. Struktura e Akademisë është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 105 datë 28.12.2011 me një organikë prej 12 punonjësish, e cila është ndryshuar në vijim me Urdhrin e Kryeministrit Nr.44 datë 10.02.2014 “Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.105 ” duke strukturuar një administratë prej 9 punonjësish.

Në strukturën organike të Akademisë konstatohet mungesa e dy punonjësve specialist të Drejtorisë së Programeve të cilët janë pjesë e stafit të trajnuesve të përhershëm të Qendrës për të cilët është bërë njoftimi pranë DAP nëpërmjet Formularit të Raportimit mujor, i përditësuar së fundi më datën 10 Nëntor 2017, por këto vende vakante nuk rezultojnë të jenë shpallur ende prej DAP-it si parashikohet në Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 243, datë 18.3.2015 “Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive”. Në tabelën më poshtë paraqitet në formë krahasuese struktura e miratuar sipas funksionit dhe punonjësit faktik të Qendrës.

Nr.	Emërtimi I funksionit	Nr. Punonjësish sipas Strukturës	Nr. Punonjësish fakt dt. 31.10.2017	Diferenca
I	Drejtor I Përgjithshëm	1	1	0
II	Sekretar/Protokollist	1	1	0
III	Drejtor I Drejtorisë së Programeve	1	1	0
IV	Specialist I Drejtorisë së Programeve	4	2	2
V	Specialist I Burimeve Njerëzore dhe Financës	1	1	0
VI	Specialist Shërbimesh	1	1	0
T o t a l		9	7	2

II- Organet drejtuese të kësaj qendre janë Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Krijimi dhe Veprimtaria e Bordit Drejtues të QTATD parashikohet në pikat 3,4,5,6 të VKM Nr.1264 datë 16.12.2009 ku përcaktohet se:

-Bordi drejtues është ngritur me Urdhrin e Ministrit të Financave ka në përbërje 5 anëtarë. Ky bord kryesohet nga Zëvendësministri i Financave dhe ka në përbërje:

- 1-Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve,
- 2-Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

3-Drejtorin e Drejtorisë së Politikave Fiskale e Makroekonomike, në Ministrinë e Financave,
4-Drejtorin e Akademisë.

Detyrat e bordit si organ drejtues të përcaktuara në VKM 1264 datë 16.12.2009 janë:

a) Përcakton çdo vit programet e trajnimit të detyrueshëm dhe atij fakultativ të Akademisë;

b) Merr vendime për veprimtarinë e Akademisë;

c) Një herë në vit, miraton tarifat:

- për kurset e trajnimit bazë në administratën tatimore ose doganore, për personat që dëshirojnë të bëhen pjesë e tyre administrative;


- për trajnimin e personave, që janë në periudhë prove;

- te tjera për kurset fakultative;

ç) Miraton kriteret shtesë, që duhet të plotësojnë trajnuesit;

d) Miraton statutin dhe rregulloren e brendshme të Akademisë.

Më poshtë paraqitet organigrama e QTADT.



Gjatë veprimtarisë së tij prej prej krijimit bordi ka kryer vendimmarrje vetëm në tre raste dhe ka dalë me një vendim në vitin 2013, vendimi Nr.1 datë 23.04.2013, ku ndër të tjerat është miratuar Statuti dhe Rregullorja e Qendrës, dhe dy vendime në vitin 2014 përkatësisht Vendimin Nr.1 datë 17.06.2014 dhe Nr. 2 datë 09.09.2014. Gjatë periudhës Janar 2015 deri më Tetor 2017 bordi rezulton i mbledhur vetëm një herë, kështu sipas procesverbalit të mbledhjes më datë 03.05.2017 është realizuar mbledhja e Bordit Drejtues në të cilën kanë marrë pjesë 5 (pesë) anëtarët e tij. Në këtë mbledhje janë zhvilluar diskutime lidhur me programet e trajnimit, kalendarin e tyre, kohëzgjatjen e tyre etj. Në përfundim të kësaj mbledhje nuk është marrë vendim për çështjet e trajtuara prej anëtarëve pjesëmarrës, evidentuar kjo në procesverbalin e mbledhjes të përcjellë Kryetarit të Bordit.

Në vijim sipas dokumentacionit dhe informacionit vënë në dispozicion të grupit të auditimit paraqitennë mënyrë të përmbledhur të gjitha Vendimmarrjet e bordit lidhur me veprimtarinë e QTATD si vijon:

Me Vendimin Nr.1 datë 23.04.2013 bordi ka vendosur:

1. Miratimin e Statutit dhe Rregullores së veprimtarisë së Qendrës
2. Përcaktimin e tarifës ditore të trajnuesve në masën 6,000 lekë
3. Përcaktimin e tarifës së pjesëmarrjes në kurs në masën 30,000 lekë
4. Fillimin brenda dy javëve të kurseve të para trajnuese

Me Vendimin Nr.1 datë 17.06.2014 bordi ka vendosur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

1. Ngritjen komisioneve të vlerësimit të provimeve për tatimet dhe doganat me 5 pesë anëtarë dhe përbërjen e tyre
2. Hartimin e tezës dhe mënyra e përgatitjes së saj
3. Shpërblimi për anëtarët e komisionit të vlerësimit në masën 20,000 lekë
4. Përcaktimi ambienteve dhe kohës së zhvillimit të testimit për datat 24 Qershor 2014 dhe 7 Korrik 2014
5. Miratimi i procedurës së zhvillimit të testimit
6. Miratimin e rregullores së testimit
7. Miratimin e kritereve shtesë për trajnerët part-time me miratim sipas llojit të programit
8. Përzgjedhjen e lektorëve dhe tarifave të tyre
9. Miratimi i tipit të çertifikatës që do të lëshohet
10. Miratimi i programit të trajnimeve
11. Miratimi i tarifës 0 (zero) për pjesëmarrësit në këto trajnime
12. Organizimet me karakter fakultativ sipas kërkesave specifike të organeve fiskale

Me vendimin Nr. 2 datë 09.09.2014 bordi ka vendosur:

1. Miratimin e programeve të trajnimit për administratën tatimore dhe doganore për pjesën e dytë të vitit 2014
2. Miratimi i programeve të trajnimit vazhdues dhe pyetësorët që do të përdoren për të vlerësuar nevojat e personelit për vitin 2015 për të dy administratat fiskale
3. Miratimin e skemës që do të ndiqet për organizimin e trajnimeve
4. Miratimi i tarifave
 - a) Për kurset bazë për personat të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e këtyre administratave në masën 1,000 lekë/leksion
 - b) Për personat përsëritës në masën 500 lekë/leksion
 - c) Për trajnimet e tjera për kurset fakultative përfshirë pjesëmarrës jashtë strukturës, të jetë në masën 1,000 lekë/leksion

Sa më sipër vihet re që bordi drejtues i QTATD për periudhën nën auditim Janar 2015 deri më Tetor 2017 nuk rezulton të ketë ushtruar vendimmarrje në përputhje me kërkesat e VKM Nr.1264 datë 16.12.2009 pika 4), për përcaktimin e programet e trajnimit, miratimin e tarifave, si dhe vendimmarrjeve të tjera të rëndësishme për mirëfunksionimin e kësaj qendre. Për vitin 2015 janë miratuar programet e trajnimit vazhdues sipas vendimit të Bordit Drejtues Nr. 2 datë 09.09.2014, ndërsa për periudhat e tjera në vijim ka munguar vendimmarrja duke lënë pa përcaktuar programet e trajnimit të detyrueshëm dhe fakultativ për çdo fushë, të cilat duhet të drejtoheshin respektivisht administratave përkatëse në kuadrin e misionit të kësaj qendre për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të përgjithshme administrative institucionale për administratën fiskale. Konstatohet se pavarësisht mungesës së vendimmarres së bordit, Qendra ka vijuar workshop-et, seminarët dhe trajnimet e kërkuara prej Administratës Tatimore dhe Doganore sipas rastit. Kërkesat për trajnimin e punonjësve të rinj apo dhe atyre për formimin e vazhdueshëm të punonjësve janë miratuar prej drejtuesve të institucioneve Tatimore dhe Doganore, të cilët janë edhe anëtarë të bordit drejtues të QTATD. Pra vihet re që tre prej pesë anëtarëve të këtij bordi për cilësitë e tyre funksionale, kanë vijuar bashkëpunimin në funksion të misionit të kësaj qendre për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore në fushën fiskale. Bashkëpunimi i drejtuesit të QTATD me të dy administratat fiskale për trajnimin specifik, të mëtejshëm fiskal të punonjësve të tyre mbi bazën e kalendarëve të dakordësuar midis palëve si për sa i përket programeve të trajnimit, trajnerëve me përvojë vënë në dispozicion prej këtyre administratave por edhe krijimit të kushteve të nevojshme për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”


trajnim si mbientedhe logjistikë në rastet e trajnimeve jashtë ambienteve të kësaj qendre ka bërë që qendra të plotësojë disa nga drejtimet e veprimtarisë të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Konstatohet një mungesë në përmbushjen e detyrimeve prej bordit drejtues për adresimin e problematikave, të cilat hasen në zbatimin e VKM Nr.1264 datë 16.12.2009, nevojës që kjo bazë ligjore të jetë në harmoni me misionin e qendrës por edhe me aktet e tjera ligjore në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës publike dhe formimin profesional të punonjësve publikë. KLSH thekson se roli i menaxhimit të burimeve njerëzore për administratën tatimore dhe doganore është mjaft i rëndësishëm për evidentimin e nevojave dhe mbështjen me trajtime dhe asistencë teknike specifike për fushën fiskale, duke siguruar kështu një shërbim civil profesional në këtë administratë.

Gjatë periudhës nën auditim 01.01.2015 deri më 31.10.2017 qendra në bashkëpunim me administratën Tatimore dhe Doganore ka realizuar sipas kërkesave të tyre trajnimet vijon :

Periudha	Të trajnuar	Trajner	Tema	Orë
Viti 2015	3,699	186	44	835
Viti 2016	732	30	23	347
Janar-Tetor 2017	941	56	28	348
Shuma	5,372	272	95	1,530

Në pamje grafike veprimtaria trajnuese për periudhën në auditim paraqitet:



Si vërehet edhe në paraqitjen grafike të mësipërme, viti 2015 përfaqëson pikën ku numri i trajnimeve paraqitet më i lartë krahasuar me vitet 2016 dhe 2017, rjedhja e kësaj kryesisht e nevojës së administratave fiskale për të njohur punonjësit me ndryshimet e reja ligjore në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri “Për TVSH-në” në muajin Janar 2015, duke evidentuar kështu rëndësinë e trajnimeve specifike në fushën fiskale. Po kështu nisma anti informalitet e ndërmarrë gjatë kësaj periudhe pjesë e së cilës janë dhe administratat tatimore dhe doganore ka evidentuar nevojën për trajnime të vazhdueshme të administratës fiskale por edhe fusha të tjera të kërkuara zyrtarisht prej dy administratave.

Në tabelën më poshtë paraqiten trajnimet e realizuara nga QTATD për të secilën prej administratave:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Periudha Janar 2015 - Tetor 2017	Në numër
Totali të trajnuar (tatime+dogana)	5,372
Totali trajner (tatime+dogana)	272
Totali temat (tatime+dogana)	95
Totali orë (tatime+dogana)	1,530

Në total prej Akademisë Fiskale për periudhën në auditim janë trajnuar gjithsej 5,372 punonjës fiskalë, janë angazhuar gjithsej 272 trajnerë pa pagesë pjesë e stafeve e të dy strukturave, tatime dhe doganë sipas rastit ku janë trajtuar 95 tema në total të cilat i përkasin veprimtarisë fiskale sipas nevojave të evidentuara nga administratave respektive. Sipas të dhënave pjesët repektive të trajnimit që ka zënë secila nga administratat e fiskut, trajnimet e administratës tatimore zënë rreth 70 % të numrit të përgjithshëm të trajnimeve, ndërsa administrata doganore zë 30% të këtij numri. Në përfundim të trajnimeve për formimin e vazhdueshëm të punonjësve janë kryer testimet rezultatet e të cilave janë dërguar njëkohësisht administratës përkatëse dhe ASPA-s.

Administrata	TATIME				DOGANA			
	Të trajnuar	Trajner	Tema	Orë	Të trajnuar	Trajner	Tema	Orë
Janar-Dhjetor 2015	2,565	156	18	710	1,134	30	26	125
Janar-Dhjetor 2016	714	29	12	336	18	1	11	11
Janar-Tetor 2017	481	40	20	228	460	16	8	120
Shuma	3,760	225	50	1,274	1,612	47	45	256

Më poshtë paraqitet grafikisht pjesëmarrja e trajnuesve të jashtëm dhe temave të zhvilluara në këto trajnime sipas periudhave.



- VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” ka përcaktuar se QTATD drejtohet nga një Bord Drejtues megjithëse ky është një institucion në varësi të Ministrisë të Financave. Kjo formë organizimi nuk mbështetet në Ligjin Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore” i cili në nenin 18 përcakton se “Institucioni i varësisë organizohet si drejtori apo drejtori e përgjithshme, në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë përkatëse. Niveli i organizimit përcaktohet në vendimin e krijimit”. Po kështu forma e organizimit me Bord Drejtues sipas VKM nr.1264 nuk i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

përshtatet as formës së organizimit të një Agjencie Autonome, e cila duhet të bëhet me ligj dhe jo me VKM si në rastin konkret.

Në VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” përcaktohet se;

- “Trajnuesit e Përhershëm” sipas përcaktimit në pikën 9, nuk kryejnë veprimtari trajnuese megjithëse në emërtimin e tyre trajtohen si të tillë. Detyra e tyre e përcaktuar në VKM ekzistuese është të sigurojnë mbështetjen për organizimin e trajnimeve, monitorimin, plotësimin, dhe vlerësimin e rezultateve të trajnimit për çdo nëpunës. Emërtimi dhe detyrat e punonjësve të brendshëm të qendrës të emërtuar “*Trajnues të Përhershëm*” kërkojnë kapacitete profesionale të një niveli të lartë të cilat duhet të jenë mirëpërcaktuar në bazën ligjore, në mënyrë që të mos jenë të prekshme nga vendimmarrje të një niveli më të ulët.

- Baza rregullative parashikon edhe “Trajnuesit part-time” të cilët ndryshe nga punonjësit e përhershëm dhe punonjësit administrativë me të cilët përcaktohet lidhja e kontratës së punës sipas pikës 8/dh dhe 8/ë, pikën 10 të saj, përcaktohet termi kontraktim “*Trajnuesit e kontraktuar me kontrata part-time...*” duke i kthyer këta trajnerë në staf që duhet të deklarohen nga qendra si të punësuar dhe për të cilët duhet të derdhen edhe sigurime shoqërore, fakt që e rrit koston në nivele të paparashikuara. Ky përcaktim ka bërë që QTATD të përfshijë në procesin trajnues vetëm trajnerë të marrë nga administrata tatimore dhe doganore pjesë të administratës publike dhe që e kanë kryer këtë mision pa pagesë shtesë.

Nga ana tjetër në kriteret e përgjithshme për kontraktimin e “*Trajnuesve part-time*” sipas 10/b të VKM përcaktohet dhe rasti që këta trajnerë të jenë të punësuar në poste drejtuese në administratën publike me përvojë të paktën 5-vjeçare. Kriera të lidhura me funksionet dhe jo kapacitet e personave që përfshihen për trajnerë, ul nivelin e trajnimeve dhe krijon risqe operationale për sa kohë vlerësimi i trajnimit ndikon në vlerësimin e punonjësit tatimor apo doganor.

- VKM nr.1264 datë 16.12.2009 përcakton se “*Punonjësit në periudhe prove, të cilët nuk kalojnë provimin e vlerësimit të organizuar pranë Akademisë, nuk konfirmohen për përfundimin me sukses të periudhës së provës*” aspekt që ka një rregullim tjetër në bazë të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” sipas të cilit Shkolla Shqiptare e Administratës Publik (ASPA) është institucioni që duhet të realizojë vlerësimin e nëpunësit civil për periudhën e provës pas përfundimit të ciklit të detyrueshëm të trajnimit.

- Megjithëse ngarkesën më të madhe të trajnimeve të administratës tatimore dhe doganore i realizon kjo qendër, konstatohet se brenda strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka një sektor të veçantë për trajnimin e punonjësve. Duhet të theksojmë se Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore e cila në fokusin e veprimtarisë së saj ka pikërisht trajnimin e administratës fiskale, ka anëtarë të Bordit Drejtues Titullarët e këtyre 2-Drejtorive, çka tregon qartë mosfunksionimin e duhur të niveleve drejtuese të këtyre institucioneve në drejtimin e personelit, për sa kohë që konstatohen kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

🚩 Drejtimi 2: “Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, rregullshmëria e zbatimit të kuadrit ligjor në shpenzimet për paga dhe shpërblime, shpenzime operative dhe shpenzime të tjera”.

Programimi Buxhetor Afatmesëm për të tre periudhat objekt auditimi është kryer në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” si dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave sipas viteve përkatës “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, ku Qendra



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim dhe i ka dërguar në Ministrinë e Financave. Për vitin 2016, PBA është bërë në dy faza, ndërsa për vitin 2015 dhe 2017 subjekti dispononte vetëm programimin për fazën e dytë, pasi planifikimi ishte kryer nga Ministria e Financave, në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e administratës shtetërore”, neni 18, pika 4 përcaktohet se “shërbimet mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm në institucionet e varësisë me një numër të vogël punonjësish kryhen nga struktura përgjegjëse e ministrisë përgjegjëse”. Në mënyrë të përmbledhur planifikimi i shpenzimeve për tre vitet objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	PBA (2015-2017)	PBA (2016-2018)		PBA (2017-2019)
			Faza I	Faza II	
1	Paga e shtesa	9,500	9,500	9,500	9,500
2	Kontribute të sigurimeve shoqërore	1,500	1,500	1,500	1,500
3	Blerje mallra e shërbime	5,000	5,000	5,200	5,200
4	Investime	500	0	0	0
TOTALI (I+II+III+IV)		16,500	16,000	16,200	16,200

Pra, siç vihet re edhe nga tabela e mësipërme, planifikimi buxhetor afatmesëm për të tre vitet për QTADT, është bërë për shumën totale rreth 16 milion lekë.

Në lidhje me programin buxhetor përfundimtar të miratuar nga Ministria e Financës, nga ana e subjektit nuk na u vunë në dispozicion shkresat përkatëse me anë të së cilave është dërguar buxheti për të gjetur më pas zbatim nga Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore. Realizimi i shpenzimeve sipas planifikimit në PBA, atij buxhetor dhe realizimi faktik për 3 periudhat objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Emërtimi	Fakti 2014	2015				2016				2017				
		PBA (2015-2017)	Plani	Realizimi	Diferenca	PBA (2016-2018)		Plani	Realizimi	Diferenca	PBA (2016-2018)	Plani	Realizimi (Tetor 2017)	Diferenca
						Faza I	Faza 2							
SHPENZIME														
Paga e shtesa	3,961	9,500	9,500	3,600	- 5,900	9,500	9,500	9,500	3,437	563	9,500	9,500	3,677	-5,823
Sigurime shoqërore	630	1,500	1,500	574	- 826	1,500	1,500	1,500	548	952	1,500	1,500	588	-912
Mallra e shërbime	196	5,000	5,000	83	- 4,917	5,000	5,200	5,000	81	4,919	5,200	5,200	64	-5,136
Investime	0	500	0	0	-500	0	0	0	0	0	0	0	0	-
TOTALI	4,787	16,000	16,000	4,257	-11,663	16,000	16,200	16,000	4,066	-11,934	16,200	16,200	4,330	11,870

Realizimi faktik i shpenzimeve të vitit 2014 ka qenë në shumën 4,787 mijë lekë dhe në PBA e vitit 2015 janë programuar 16 milion lekë shpenzime për QTADT, pra rreth 11,713 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë. Nga ky planifikim buxhetor, institucioni ka vënë në përdorim 4,257 mijë lekë, pra 11,663 mijë lekë më pak se plani.

Në vitin 2016, PBA e planifikuar në dy faza dhe plani buxhetor përfundimtar ka qenë rreth 16 milion lekë, pra janë programuar rreth 11,743 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë. Nga ky planifikim buxhetor, institucioni ka vënë në përdorim 4,066 mijë lekë, pra 11,934 mijë lekë më pak se plani.

Në vitin 2017 PBA në fazën e dytë dhe planifikimi buxhetor paraqitet në shumën 16,200 mijë lekë, pra rreth 12,134 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë. Nga ky plan, institucioni deri në fund të tetorit 2017 ka shpenzuar 4,330 mijë lekë, pra 11,870 mijë lekë më pak se plani.

Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, për vitin 2015, 2016 dhe 2017 nuk rezulton të ketë realizuar shpenzime për investime apo të tjera, por vetëm për paga dhe




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

sigurime shoqërore (nuk janë kryer shpenzime për shpërblime) sipas organikës të miratuar për punonjësit e saj si dhe disa shpenzime me vlerë relativisht të ulët për blerje mallrash dhe shërbimesh.


Në mënyrë grafike, situata paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë



Pra, vihet re një planifikim rreth 3 herë më shumë se realizimi faktik i institucionit për të tre vitet objekt auditimi. Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore ka realizuar shpenzime më pak se 5 milion lekë për të tre vitet, dhe PBA në fazën e dytë, si dhe planifikimi përfundimtar ka qenë në shumën rreth 16 milion lekë. Më hollësisht, ecuria e shpenzimeve të QTADT është si më poshtë:

Në mijë lekë



Panifikimi dhe zbatimit të buxhetit të Qendrës së Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore rezultoi se për periudhën objekt auditimi, shpenzimet e realizuara nga institucioni ishin dukshëm më të ulëta se planifikimi i tyre, për shkak të mungesës së koordinimit me strukturën administrative të Ministrisë së Financave për kryerjen e procedurave përkatëse për blerjen e mallrave, dhe mos plotësimin të pozicioneve vakante nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Më hollësisht, planifikimi buxhetor dhe realizimi për 3 vitet objekt auditimi paraqitet si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

1. Mbi hartimin e buxhetit, zbatimin dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe udhëzimet nga Ministria e Financave për çdo vit, ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këto udhëzime dhe duke respektuar afatet përkatëse. Bashkëngjitur planifikimit të vitit aktual dhe atij afatmesëm janë edhe formularët shoqërues në lidhje me argumentimin e kërkesave buxhetore në vitet përkatës. Përlllogaritjet në zërin paga e sigurime shoqërore, janë kryer mbështetur në numrin e punonjësve të strukturës së miratuar dhe në zbatim të VKM-së në fuqi. Fondi i shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, që i nevojiten institucionit për fillimin e veprimtarisë për të mbuluar nevojat e domosdoshme për funksionimin e tij, është planifikuar duke marrë parasysh shpenzimet e periudhave të mëparshme dhe aktivitetet e planifikuara për tu zhvilluar gjatë këtij viti. Planifikimi i investimeve nga ana e institucionit është bërë vetëm për vitin 2014, ndërsa për vitin 2015 dhe 2016 këto investime janë programuar në vlerën 0 (zero).

Viti 2015

Programimi i shpenzimeve buxhetore në fazën e I^{re} të PBA 2015-2017

Programimi në fazën e parë nuk rezulton të jetë kryer nga ana e QTADT, dhe nuk disponohen shkresa për përcjelljen e dokumentit në Ministrinë e Financave.

Programimi i shpenzimeve buxhetore në fazën e II^{te} të PBA 2015-2017

Programimi në fazën e dytë është bërë në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017”, si dhe VKM-së nr. 110, datë 27.02.2014 “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017”, Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Përcjellja e projekt buxhetit për fazën e dytë të PBA-së, është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 467/1, datë 02.04.2014 “Dërgohen kërkesat buxhetore për fazën e parë të PBA-së 2015-2017”. Shpenzimet totale janë programuar në shumën 16,500 mijë lekë, të ndara në:

- Shpenzime për paga e shtesa (600), në vlerë 9,500 mijë lekë;
- Shpenzime për sigurime shoqërore (601), në vlerë 1,500 mijë lekë;
- Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh (602) në vlerë 5,000 mijë lekë;
- Shpenzime për investime (231) në vlerë 500 mijë lekë.

Shpenzimet totale për vitin 2015 janë programuar rreth 11,713 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë (në vitin 2014 këto shpenzime paraqiteshin në shumë 4,787 mijë lekë).

Më hollësisht, fondi i pagave për vitin 2015 në PBA (2015-2017) është programuar në vlerën 7,563,420 lekë sipas organikës me 9 punonjës, si dhe planifikimi i shpenzimeve për blerje mallrash dhe shërbimesh (llogaria 602), në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2013	I pritshmi 2014	Parashikimi 2015	Kërkesa 2016	Kërkesa 2017
	Blerje mallra e shërbime					
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	9	1,890	1,050	1,160	1,160
2	Shërbime nga të tretë	149,033	2,000	3,370	3,400	3,400
3	Shpenzime transporti	0	230	150	170	170
4	Shpenzime udhëtimi	0	500	150	170	170
5	Shpenzime të tjera operative	0	480	280	300	300



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

TOTALI (I+II+III+IV+V)	158,953	5,100	5,000	5,200	5,200
-------------------------------	----------------	--------------	--------------	--------------	--------------

Pra, siç shihet edhe nga tabela, shpenzimet faktike për vitin 2013 për blerje mallrash dhe shërbimesh kanë qenë në shumën 158,953 mijë lekë, ndërsa në fazën kur është përgatitur PBA e fazës së dytë, shpenzimet e pritshme për vitin 2014 kanë qenë në shumën 5,100 mijë lekë, pra rreth 3% e shpenzimeve të një viti më parë. Kjo vjen si pasojë e kurrjes të ndjeshme të shërbimeve nga ky institucion, ku nuk janë kryer procedura prokurimi dhe materialet e zyrës apo shpenzime të tjera nga të tretë janë mundësuar nga Ministria e Financave. Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2015,2016 dhe 2017 është kryer në vlerë të përafërt me atë të vitit 2014. Në lidhje me planifikimin e investimeve sipas PBA 2015-2017, situata paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti 2014	Realizuar 2014	Parashikimi 2015	Kërkesa 2016	Kërkesa 2017
	Investime Publike me Financim të Brendshëm					
1	Pajisje Zyresh	1,000	0	350	0	0
2	Blerje pajisje kompjuterike	700	0	150	0	0
	TOTALI (I+II)	1,700	0	500	0	0

Pra, në buxhetin e vitit 2014 edhe pse ishin programuar shpenzime për investime në shumën 1,700 mijë lekë për QTADT, ato nuk janë realizuar, dhe në PBA 2015-2017 janë programuar investime në shumën 500 mijë lekë.

Çelja, detajimi dhe ndryshimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2015.

Realizimi i shpenzimeve bazuar në planifikimin buxhetor afatmesëm dhe atë përfundimtar për vitin 2015, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2014	2015			Diferenca	Në %
			PBA (2015-2017)	Plani Përfundimtar	Fakti		
	SHPENZIME						
1	Paga e shtesa	3,961	9,500	9,500	3,600	- 5,900	37%
2	Kontribute të sigurimeve shoqërore	630	1,500	1,500	574	- 826	38%
3	Blerje mallra e shërbime	196	5,000	5,000	83	- 4,917	1,7%
4	Investime	0	500	0	0	-500	-
	TOTALI (I+II+III+IV)	4,787	16,500	16,000	4,257	-11,663	25.8%

Realizimi i shpenzimeve gjithsej për vitin 2015, në vlerë **4,257 mijë lekë**, krahasuar me planin përfundimtar, i cili është 500 mijë lekë më pak se PBA (2015-2017) në vlerë 16,500 mijë lekë, është realizuar në masën 25.8%, ose realizuar më pak për 11,663 mijë lekë. Krahasuar me nivelin e shpenzimeve të një viti më parë, në vitin 2015 rezultojnë 530 mijë lekë më pak shpenzime se periudha paraardhëse.

Në vitin 2015 QTADT është gjobitur nga Drejtoria e Apelimit Tatimor në shumën 10,000 lekë dhe si pasojë e apelimit të këtij vendimi nga institucioni sipas shkresës nr. 37346/1 prot datë 15.01.2016, kjo shumë është deklaruar në Drejtorinë e Thesarit si të ardhura të patatueshme në Buxhetin e shtetit. Këto të ardhura për buxhetin janë kontabilizuar si të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi ndërtimi (llogaria 7116) dhe faktikisht duhet të kontabilizohet në llogarinë 7115 (gjoba dhe kamatëvonesa).

Në fund të vitit 2015, shuma prej 11,743,066 lekë (nga e cila 11,753,066 lekë tepriçë nga të ardhurat totale të alokuara nga Buxheti dhe 10,000 lekë të ardhura të patatueshme nga subjekti) janë transferuar në Buxhetin e Shtetit si fonde të paprekura nga institucioni.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Në vitin 2016

Programimi i shpenzimeve buxhetore në fazën e I^{re} të PBA 2016-2018

Programimi i fazës së parë të shpenzimeve buxhetore në QTADT është bërë me shkresën nr. 83 prot datë 14.05.2015, ku janë dërguar pasqyrat për projekt buxhetin në fazën e parë të PBA me subjekt “Dërgohen pasqyrat e projektbuxhetit për vitin 2016-2018”. Shpenzimet totale janë programuar në shumën 16,500 mijë lekë, e ndarë në:

- Shpenzime për paga e shtesa (600), në vlerë 9,500 mijë lekë;
- Shpenzime për sigurime shoqërore (601), në vlerë 1,500 mijë lekë;
- Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh (602) në vlerë 5,000 mijë lekë;
- Shpenzime për investime (231) në vlerë 500 mijë lekë.

Shpenzimet totale për vitin 2015 janë programuar rreth 11,743 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë (në vitin 2015 këto shpenzime paraqiteshin në shumë 4,257 mijë lekë).

Programimi i shpenzimeve buxhetore në fazën e II^{te} të PBA 2016-2018

Programimi në fazën e dytë është bërë në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave, Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Përcjellja e projekt buxhetit për fazën e dytë të PBA-së, është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 467/1, datë 02.04.2014 “Dërgohen kërkesat buxhetore të QTADT për fazën e parë të PBA-së 2015-2017”. Shpenzimet totale janë programuar në shumën 16,000 mijë lekë, e ndarë në:

- Shpenzime për paga e shtesa (600), në vlerë 9,500 mijë lekë;
- Shpenzime për sigurime shoqërore (601), në vlerë 1,500 mijë lekë;
- Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh (602) në vlerë 5,000 mijë lekë;

Shpenzimet totale për vitin 2016 janë programuar rreth 11,743 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë (në vitin 2015 këto shpenzime paraqiteshin në shumë 4,257 mijë lekë).

Më hollësisht, fondi i pagave për vitin 2016 në PBA (2016-2018) është programuar në vlerën 7,570,140 lekë sipas organikës me 9 punonjës, si dhe planifikimi i shpenzimeve për blerje mallrash dhe shërbimesh (llogaria 602), në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2014	PBA 2015	Parashikimi 2016 PBA I	Parashikimi 2016 PBA II	Kërkesa 2017	Kërkesa 2018
	Blerje mallra e shërbime						
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	108	1,020	1,050	1,050	1,050	1,050
3	Shërbime nga të tretë	87	3,180	3,350	3,350	3,400	3,400
4	Shpenzime udhëtimi	0	450	450	450	450	450
5	Shpenzime të tjera operative	0	350	350	350	300	300
	TOTALI (I+II+III+IV+V)	196	5,000	5,200	5,200	5,200	5,200

Pra, sic vihet re edhe nga tabela, realizimi faktik i shpenzimeve për blerje mallrash dhe shërbimesh në vitin 2014 ka qenë në shumën rreth 196 mijë lekë. Në PBA-në e vitit 2015-2017, janë planifikuar shpenzime në shumën 5,000 mijë lekë, pra rreth 4,904 mijë lekë më shumë se një vit më parë.

Çelja, detajimi dhe ndryshimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2016.

Realizimi i shpenzimeve bazuar në planifikimin buxhetor afatmesëm dhe atë përfundimtar për vitin 2016, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2015	2016		Fakti thesari	Difer. thesari	Në %
			PBA I (2016-2018)	PBA II (2016-2018)			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

	SHPENZIME ADMINISTRATIVE								
1	Paga e shtesa	3,600	9,500	9,500	9,500	3,457	3,437	-5,823	36%
2	Kontribute të sigurimeve shoqërore	574	1,500	1,500	1,500	551	548	-912	36%
3	Blerje mallra e shërbime	83	5,000	5,200	5,000	81	81	-5,136	1.6%
	TOTALI (I+II+III)	4,257	16,000	16,200	16,000	4,089	4,066	11,870	25%

Nga auditimi i pasqyrave financiare të dorëzuar përgatitur nga Qendra e Trajnimit të Auditimit të Doganave dhe Tatimeve, u konstatuan se ekzistojnë diferenca në masën rreth 23 mijë lekë, mes të dhënave të thesarit dhe atyre të kontabilizuara në pasqyrën e shpenzimeve për vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2016 si pasojë e një gjobë për punonjësit E. L.j dhe G. R. sipas vendimit nr. 100 prot datë 02.10.2015 nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, janë mbajtur detyrime nga paga mujore e punonjësve për muajin janar, shkurt dhe mars. Këto të ardhura për buxhetin janë kontabilizuar si të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi ndërtimi (llogaria 7116) dhe faktikisht duhet të kontabilizohet në llogarinë 7115 (gjoba dhe kamatëvones). Në fund të vitit, pjesa e fondeve të papërdorura nga QTADT është transferuar në llogarinë e Buxhetit të Shtetit.

Në vitin 2017

Programimi i shpenzimeve buxhetore në fazën e I^{re} të PBA 2017-2019

Programimi në fazën e parë nuk rezulton të jetë kryer nga ana e QTADT, dhe nuk disponohen shpresa për përcjelljen e dokumentit në Ministrinë e Financave.

Programimi i shpenzimeve buxhetore në fazën e II^{te} të PBA 2017-2019

Me shkresën nr. 60/2 datë 11.08.2016, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore i ka dërguar Ministrisë së Financave planifikimin me PBA për vitin 2017-2019, me subjekt “Dërgohen pasqyrat e PBA-së në zbatim të shkresës suaj nr. 2985/15 datë 03.08.2016”. Shpenzimet totale janë programuar në shumën 16,200 mijë lekë, e ndarë në:

- Shpenzime për paga e shtesa (600), në vlerë 9,500 mijë lekë;
- Shpenzime për sigurime shoqërore (601), në vlerë 1,500 mijë lekë;
- Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh (602) në vlerë 5,200 mijë lekë;

Shpenzimet totale për vitin 2017 janë programuar rreth 12,134 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë (në vitin 2016 këto shpenzime paraqiteshin në shumë 4,066 mijë lekë).

Më hollësisht, fondi i pagave për vitin 2017 në PBA (2017-2019) është programuar në vlerën 7,578,960 lekë sipas organikës me 9 punonjës, si dhe planifikimi i shpenzimeve (llogaria 602), në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2015	I pritshmi 2016	Parashikimi 2017	Kërkesa 2018	Kërkesa 2019
	Blerje mallra e shërbime					
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	7	1,020	1,050	1,050	1,050
3	Shërbime nga të tretë	76	3,380	3,350	3,400	3,400
4	Shpenzime udhëtimi	0	450	450	450	450
5	Shpenzime të tjera operative	0	350	350	300	300
	TOTALI (I+II+III+IV+V)	83	5,200	5,200	5,200	5,200

Planifikimi i shpenzimeve për blerje mallrash dhe shërbimesh në vitin 2016 është bërë në shumën 5,200 mijë lekë, në një kohë kur realizimi faktik i këtyre shpenzimeve për vitin paraardhës ka qenë në shumën 83 mijë lekë.

Çelja, detajimi dhe ndryshimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Sipas shkresës nr. 142, datë 31.12.2015, QTADT i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike që në vijim të VKM-së nr. 1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e qendrës së trajnimit të administratës tatimore dhe doganore” dhe sipas ligjit nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e administratës shtetërore”, neni 18, pika 4 përcaktohet se “shërbimet mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm në institucionet e varësisë me një numër të vogël punonjësish kryhen nga struktura përgjegjëse e ministrisë përgjegjëse”. Si rezultat, këtë funksion është kërkuar ta kryejë Ministria e Financave dhe në vitin 2017, pas largimit të shefes së financës në QTADT, në vijim të shkresës nr. 65 datë 10.05.2017, të QTADT nënpunës zbatues i përkohshëm është vendosur znj. R. N., nënpunëse zbatuese e Ministrisë së Financave.

Realizimi i shpenzimeve bazuar në planifikimin buxhetor afatmesëm dhe atë përfundimtar për vitin 2017, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2016	2017			Difer.	Në %
			PBA (2017-2019)	Plani Buxhetor	Fakti 31.10.2017		
	SHPENZIME ADMINISTRATIVE						
1	Paga e shtesa 600	3,437	9,500	9,500	3,677	-5,823	39%
2	Kontribute të sigurimeve shoqërore	548	1,500	1,500	588	-912	39%
3	Blerje mallra e shërbime	81	5,200	5,200	64	-5,136	1%
	TOTALI (I+II+III)	4,066	16,200	16,200	4,330	11,870	26.7%

Deri në 31.10. 2017, totali i shpenzimeve nga QTADT është në shumën rreth 4,867 mijë lekë, ku janë përfshirë vetëm shpenzime për paga, sigurime shoqërore, si dhe pagesa telefonike. Për vitin 2017, institucioni nuk ka realizuar shpenzime kancelarie, pasi këto janë mundësuar nga Ministria e Financës në vijim të shkresës nr. 85 prot datë 06.06.2017.

Në vitin 2017 në strukturën organizative të QTADT janë punësuar 2 persona të rinj dhe nga auditimi i listpagesave u konstatua se nuk është bërë sistemimi i kodit të punonjësit z. Koco Qirjaqi sipas funksionit të tij, pasi ai është regjistruar si specialist për koordinimin, në një kohë ku ai është emëruar si specialist i burimeve njerëzore dhe e financës për sektorin e shërbimeve mbështetëse.

Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave të kryejnë vlerësimin për ekzistencën e konfliktit të interesit në kryerjen e funksionit të nëpunësit zbatues për dy institucionet, përkatësisht Ministrisë së Financave dhe QTADT, si njësi vartësie e saj.

➤ Drejtimi 3: “Auditim mbikrëteret e vendosura dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e trajnuesve të përhershëm dhe atyre me kohë të pjeshme vendas dhe të huaj”.

Objekti i Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore është sigurimi i formimit profesional të Administratës.

Kjo Qendër organizon trajnime për administratën fiskale sipas VKM Nr. 1264, dt.16.12.2009, “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore “.dhe ka filluar funksionimin e saj në korrik të vitit 2012. Format e trajnimit dhe metodologjitë që QTADT ka përdorur në veprimtarinë e saj trajnuese për periudhën në auditim janë:

- Trajnimi i shkëputur nga puna, i cili përfshin:
 1. Kurset trajnuese profesionale dhe vazhduese-afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata,sipas nevojave për trajnimin e kërkuar.
 2. Seminaret.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

- Trajnimi dhe zhvillimi në vendin e punës, i cili trajtohet:
 1. Njëpërmjet dhënies së paketës njohëse në vendin e punës (për punonjësit ekzistues).
 2. Njëpërmjet dërgimit të materialeve të trajnimit në /pdf/ppt.
 3. Njëpërmjet praktikave mësimore në vendin e punës për transmetimin e dijeve.
 4. Njëpërmjet dhënies së asistencës profesionale, eskperiencës dhe përvojës nga punonjësit më me përvojë dhe nga praktikantët më të mira të realizuara.
 5. Trajnimi on-line .

Sipas VKM , Nr. 1264, dt.16.12.2009 , pika 4, gërma ç) Bordi “Miraton kriteret shtesë , që duhet të plotësojnë trajnuesit” si dhe sipas pikës 8gërma e Drejtori “Lidh kontratat me trajnuesit e sistemit part -time si dhe me trajnues të huaj sipas kriterëve dhe shpërblimeve të miratuara nga Bordi”. Nga auditimi i dokumentacionit, për vitin 2015 nuk ka mbledhje Bordi, por ka një Vendim nr.2 , të datës 09.09.2014 , i cili ka miratuar fushat e trajnimit edhe për vitin 2015 mbi bazën e të cilave janë hartuar edhe programet përkatëse për tatimet dhe doganat. Per vitin 2016, QTATD i është drejtuar znj. I.B. (Zëvendësministre e MF) me shkresën nr.prot 11 , datë 02.02.2016 me kërkesë për mbledhjen e Bordit për fushat e programeve për vitin 2016. Rezulton që nuk ka një mbledhje Bordi për këtë vit, por është vazhduar me të njëjtin program standart për punonjësit e rinj i njëjtë me atë të miratuar në Vendimin nr. 1, të Bordit, të datës 17.06.2014. Në vijim të 2017-ës, QTATD , ka zbatuar programin e trajnimeve të rakorduar dhe dakortësuar me DPT dhe DPD, si dhe programin standart të të rinjve. Gjithashtu me shkresën nr.prot. 63, date 10.05.2017, i është dërguar per miratim propozimi i programit të trajnimit Shtator-Dhjetor 2017, z. E. M. (zv. Ministër i Financave). Nga auditimi i dosjeve dhe veprimtarisë së kryer të dokumentuara, Qendra nuk ka lektorë dhe për qëllim realizimin e trajnimeve, merr lektorë nga jashtë institucionit, kryesisht nga DPT dhe DPD për cdo temë trajnimi për arsye të njohurive të veçanta dhe ekspertizës që kërkon trajtimi profesional si dhe të pronësisë që zoterojnë këto organe dhe qëllimeve të brendshme të përdorimit të dijeve teknike. Këta lektorë miratohen së bashku me temat përkatëse si pjesë e programeve të trajnimit. Për vitet respektive 2015, 2016 deri më tetor 2017 nuk disponohet dokumentacion në bazë të së cilës të jenë lidhur kontratat me trajnues part-time, si dhe nuk është kryer një vlerësim i performancës së trajnerëve. Në trajnimet e realizuara prej QTATD, janë angazhuar lektorët e DPT dhe DPD-së pa pagesë, por meqenese trajnimi është një veprimtari shtesë për këto persona dhe kërkon angazhim shtesë, kjo qendër ka dërguar shkresën me nr.prot.142 dt 22.10.2015, shkresën me nr.prot .143 ,datë 22.10.2015 , si dhe shkresën, nr.prot 21, datë 08.03.2017, Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Financave, ku kërkon pikërisht hartimin e një modeli kontrate në të cilën të përfshihet mënyra e pagesës dhe detyrimeve për lektorët e jashtëm. Këto shkresa rezultojnë pa kthim përgjigje nga ana e MF. Gjithashtu trajnerët part-time nuk mund të paguhen prej QTATD pasi kjo qendër funksionon në përputhje me Ligjin e Nëpunësit Civil është institucion buxhetor pra nuk mund të lidhë kontrata punësimi me trajnerët e jashtëm dhe nuk mundet t’i deklarojë ata si të punësuar pranë qendrës, gjë e cila kërkon një përcaktim ligjor i cili aktualisht nuk mund të garantohet nga VKM nr.1264. Për trajnimet e zhvilluara ishin listat e firmosura nga pjesëmarrësit dhe të lektorëve pjesëmarrës. Temat e trajnimit përzgjidheshin në bashkëpunim me Administratën Tatimore dhe Doganore dhe si lektor janë marrë punonjës me përvojë të këtyre administratave ,sipas gërma b) e pikës 10), të VKM nr.1264 dt 16.12.2009 “Të punësuar në poste drejtuese të administratës publike me përvojë pune të paktën 5-vjeçare”. Nga auditimi I dosjeve përkatëse të nëpunësve tatimorë dhe doganorë të cilët kanë qenë trajnues part-time, është konstatuar përputhshmëri në lidhje me këtë pikë të Vendimit nr.1264 dt 16.12.2009.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Trajnerët e përhershëm (full time), sipas pikës 9. Te VKM nr.1264, dt.16.12.2009, kanë këto detyra:

- * Të sigurojnë mbështetjen administrative për organizimin e trajnimeve .
- * Të monitorojnë plotësimin e programeve nga trajnuesit e sistemit part-time .
- * Të sigurojnë respektimin e programit të trajnimit të institutit.
- * Të bëjnë vlerësimin e rezultateve të trajnimit për cdo nëpunës dhe në rastet e vlerësimit pozitiv t'i propozojnë drejtorit lëshimin e certifikatës përkatëse.

Nga auditimi i dosjeve me zgjedhje për trajnimet përkatëse, rezulton që trajnuesit e përhershëm (të cilët janë vetëm dy nga katër që duhet të ishin sipas strukturës), kanë qenë prezent duke siguruar respektimin e programit dhe monitorimin e plotësimit të këtyre programeve. Është mbajtur regjistër periodik për çdo trajnim të kryer ku janë firmosur nga pjesëmarrësit në trajnim, lektorët e jashtëm dhe specialistët e QTATD-së. Është mbajtur regjistër i vlerësimeve për secilin punonjës pas përfundimit të çdo trajnimi dhe rezultatet e çdo testimi janë dërguar në mënyrë shkresore nga ana e QTATD –sënë DPT , DPD si dhe tek ASPA.

➤ Drejtimi 4: “Vlerësimi i mjedisit të Kontrollit të Brendshëm”

Për periudhën objekt auditimi nga auditimi mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin rezultoi se:

Sipas shkresës nr. 142, datë 31.12.2015, QTADT i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike që në vijim të VKM-së nr. 1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e qendrës së trajnimit të administratës tatimore dhe doganore” dhe sipas ligjit nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e administratës shtetërore”, neni 18, pika 4 përcaktohet se “shërbimet mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm në institucionet e varësisë me një numër të vogël punonjësish kryhen nga struktura përgjegjëse e ministrisë përgjegjëse”. Si rezultat, këtë funksion është kërkuar ta kryejë Ministria e Financave.

Gjatë vitit 2015, sipas programit të auditimit nr. 5340/1 datë 08.02.2015, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave ka paraqitur raportin e auditimit prot me nr. 5340/2 datë 24.05.2016 në Qendrën e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore. Ecuria sipas rekomandimeve në përgjigje të auditit të brendshëm, është dërguar nga QTADT me planin e masave me shkresën nr. 15/1 prot datë 06.07.2015 dhe paraqitet si më poshtë:

1. Është rekomanduar nga auditi i brendshëm, që QTADT në bashkëpunim me Drejtorinë e Legjislacionit në Ministrinë e Financave të hartojë një projekt-draft VKM nr. 1264 prot datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e QTADT” duke e harmonizuar me ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, ku QTADT është përgjigjur se e ka përgatitur draftin dhe e ka dërguar në Kryeministri.
2. Është rekomanduar nga auditi i brendshëm që QTADT të fillojë urgjentisht përditësimin e faqes së internetit nëpërmjet shërbimit të ofruar, ku sipas QTADT kjo është kryer dhe faqja funksionon aktualisht në mënyrë efektive.
3. Është rekomanduar sistemimi i blerjeve të kryera në vitin 2012 dhe të kontabilizuara gabimisht në llogarinë 602, veprim ky që sipas QTADT është kryer.
4. Është rekomanduar që QTADT të rishikojë rregulloren e trajnimit duke parashikuar një proces të vlerësimit si dhe bazuar në këto analiza, hartimin e programeve të përmirësimit të cilësisë së trajnimeve, rekrutimit të trajnerëve dhe rishikimin e fushave për trajnim, dhe përgjigja e QTADT është se formulari është aktualisht në faqen online të institucionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve. Nga auditimi rezultoi se në përputhje kuadrin ligjor, Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore posedon **Planin Operacional** për vitin 2015, me nr. 1 prot datë 15.01.2015; Planin për vitin 2016 me nr. 1 prot datë 15.01.2016 dhe Planin për vitin 2017 prot me nr. 78 datë 25.11.2016, të cilët përmbajnë në to edhe dhe axhendën e trajnimeve që janë planifikuar në mënyrë të përgjithshme nga institucioni. Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 4, germa “b” i cili citon se “*Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë*”, ky institucion ka hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike **planin strategjik** me nr. 2 prot datë 15.01.2015, për vitin 2015-2018 i cili përmban objektivat e institucionit mbi kryerjen e trajnimeve.

Sipas vendimit nr. 1, datë 23.04.2013, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin e qendrës së trajnimit të administratës tatimore dhe doganore”, bordi drejtues ka vendosur miratimin e statutit dhe rregullores së qendrës së trajnimit të administratës Tatimore dhe Doganore. Statuti me 9 nene i QTADT është i firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm z. J.C. datë 26.10.2012,

Ky institucion funksionon në përputhje me rregulloren e vendosur nga vendimi sipër cituar, ku janë përcaktuar dispozitat e përgjithshme, strukturat rregullat procedurale për funksionimin e tij si dhe detyrat specifike sipas pozicionit të punës.

Nga auditimi rezultoi se shumë nga nenet që janë parashikuar në këtë Rregullore të vitit 2013, nuk janë të përshtatura dhe të përditësuara me funksionimin aktual dhe aktivitetin që kryen realisht institucioni për periudhën objekt auditimi. Pra, nevojitet një rishikim i saj nga Bordi Drejtues, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave me qëllim përgatitjen e një rregulloreje të re konform aktivitetit të Qendrës së Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Nga auditimi i kryer rezultoi se në mbështetje të kuadrin ligjor ekzistues mbi etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet midis eprorëve dhe punonjësve të çdo niveli hierarkie, apo marrëdhëniet me të tretët, në QTADT nuk ekziston një kod i posaçëm etik, por në nenin 15 të rregullores është përcaktuar “**Etika për punonjësit e Akademisë**” dhe operohet mbështetur në të.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Në drejtim të përcaktimit të strukturës organizative në funksion të objektivave të institucionit, konstatohet se kjo strukturë është e përgatitur sipas organikës me 9 punonjës sipas Urdhritë Kryeministrit Nr.44 datë 10.02.2014 “Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.105. Megjithatë, në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

lidhje me pozicionin e financ - burime njerëzore, pas largimit të specialistes së burimeve njerëzore dhe financës, ky funksion nuk rezulton të ketë kryer nga punonjësi i emëruar për këtë pozicion në qershor 2017, pasi marëdhëniet me thesarin apo çështje të tjera financiare i kryen faktikisht specialistja e protokoll arkivës.

Në bazë të kërkesave të ligjit nr. 10296, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, cilësohet se *“Nëpunësi zbatues i njësisë publike është punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike, me diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike ose juridike, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike dhe raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave”*, u konstatua se në institucion gjen zbatim neni 7 dhe 12 i ligjit nr. 10296 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” përse i përket ekzistencës së Nënpunësit Zbatues dhe Autorizues. Nënpunëse autorizuese për vitin 2015, 2016 dhe 2017 ka qenë znj. V. R.. Në vitin 2017, pas largimit të znj. A. O., e cila ishte nëpunëse zbatuese e institucionit , në vijim të shkresës nr. 65 datë 10.05.2017, të QTADT nëpunës zbatues i përkohshëm është vendosur znj. R. N., nëpunëse zbatuese e Ministrisë së Financave.

Në lidhje me pikën 1, neni 18 i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar citon se *“Nënpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”*, për shkak të madhësisë së vogël të institucionit dhe menaxhimit të pjesshëm të tij nga ana e Ministrisë së Financave, nuk rezulton të jenë depozituar deklarata apo raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm apo pyetësor vetëvlerësimi. E njëjta gjë vlen edhe për pikën 2 të nenit 16 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar si dhe mbështetur në shtojën V Manualit të Menaxhimit Financiar i miratuar me Urdhër të Ministrit të **Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 për miratimin dhe arkivimin e gjurmës** së auditimit si dhe pikë 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”, ku për 3 vitet objekt auditimi nuk rezulton të jetë mbledhur GMS-ja. Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t’i verifikuar këto transaksione dhe operacione. *Është përgjegjësi e Nëpunësit Zbatues të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to dhe meqenëqë ky rol menaxhohet nga MF, QTADT nuk ka dijeni për to.*

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit

Punonjësit e QTADT disponojnë të gjithë statusin e nëpunësit civil, dhe funksionojë sipas kuadrit ligjor përkatës për nëpunësin civil; përvec specialistes të protokoll- arkivës e cila është e punësuar sipas një kontrate pune. Në lidhje me delegimin e kompetencave, sipas nenit 15 të MFK “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

“Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, pasi nuk është konsideruar e nevojshme, për shkak edhe të numrit të punonjësve dhe veprimtarisë së institucionit.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, janë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Nga ana e titullarit, është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, dhe i është bashkëlidhur disa prej dosjeve së gjithsecilit punonjës. Nga auditimi vihet re disa prej dosjeve nuk janë të plota ku vihet re mungesa e shumë dokumenteve përkatës, ku dhe evidentohet nevoja për marrjen e masave nga institucioni për plotësimin e tyre.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, në Qendrën e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore nuk rezultojnë të jenë organizuar trajnime me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit, paragrafi “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Gjatë 3 viteve objekt auditimi institucioni ka konstatuar mungesa në organikën e tij, ku sipas QTADT është bërë një komunikim elektronik me DAP-in, por nuk janë marë masat për plotësimin e vendeve vakante në insitucion.

2. Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”, Qendra e trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore disponon një regjistër risku, të përcaktuar në 3 vite si më poshtë:

Sipas dokumentit me nr. 1/3 prot datë 15.01.2015, “Për delegimin e detyrave për koordinimin e riskut”, Drejtoresha e Përgjithshme e QTADT ka vendosur si koordinator risku z. G. R. dhe bashkëlidhur këtij materiali është regjistri i riskut ku ndër risqet e listuara përmenden:

-Mungesa e lektorëve disponibël në kohë dhe me kualifikimin e duhur;

-Mungesa e një faqe ëeb me qëllime trajnimi;

-Zhvillimi i trajnimeve paralelisht me tatimet dhe doganat.

Në vitin 2016, regjistri i riskut është përgatitur sipas dokumentit prot nr. 4 datë 29.01.2016 “Për delegimin e Detyrave për koordinimin e riskut” ku është vendosur përgjegjës risku znj. A. O.. Në këtë dokument institucioni ka listuar komponentët që përbëjnë risk për mbarëvajtjen e tij, ku përmenden:

-Kushtet jo optimale akomodimi si pasojë e mungesës së sallave, lektorëve dhe pajisjeve;

- Mungesa e një kalendari për trajnimet me datat dhe lektorët përkatës;

-Numri i madh i pjesëmarrësve në trajnim, i papërballueshëm nga stafi;

-Trajnime jashtë planifikimit.

Për vitin 2017, QTADT **nuk ka vendosur një koordinator risku** dhe sipas dokumentit prot me nr. 1 datë 09.01.2017, janë vendosur si risqe ato të njëjta me vitin paraardhës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

3. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-se”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, institucioni **nuk ka hartuar gjurmët e auditimit** që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj. Gjithashtu, sic u përmend dhe më sipër duke qenë se rregullorja e insitucionit është e pa përditësuar, është e vështirë kryerja e kontrollit për zbatimin e detyrave dhe specifikave sipas pozicionit të punës sipas organikës së punonjësve si dhe funksionimi i aktivitetit si i tërë.

4. Informim komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive. Insitucioni nuk ka parashikuar në rregulloren e tij ndonjë pikë në lidhje me mënyrën e përdorimit, rregullave apo ruajtjen e informacionit të pajisjeve elektronike që disponon. Gjithashtu në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” institucioni ka përgatitur programin e transparencës i cili përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit. Ky program gjendet edhe në faqen zyrtare të institucionit, tek “Programi i Transparencës”.

Institucioni nuk ka një strukturë të marrëdhënieve me publikun dhe me jashtë, të cilët komunikojnë me subjektet e jashtme. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike (adresa e-maili zyrtare të njëjta me ato të ministrisë së financave) dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se subjekti nuk kishte një sistem të mirë për mbajtjen dhe regjistrimin e trajnimeve sipas datave përaktëse. Këto trajnime mund të publikoheshin në faqen zyrtare të institucionit ku të interesuarit mund të informoheshin për datat e zhvillimit të tyre dhe tematikat përkatëse.

5. Monitorimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Në këtë institucion, nga ana e punonjësve nuk rezulton të jetë kryer raportim peridoik për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit për çdo proces e pozicion pune, duke krijuar kështu boshllëqe në garantimin e një cilësie të mirë për cdo pozicion, dhe institucionin si i tërë. Në kreun III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, citohet: “Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi.” Si rezultat, nga auditimi u konstatua se sipas nenit 11 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke qenë se institucioni është në varësi të Ministrisë së Financave, dhe pas vendosjes së nënpunëses zbatuese të njëjtë me atë të Ministrisë, nuk rezulton të ketë një komunikim të rregullt shkresor mes Ministrisë dhe QTADT për sigurimin e mbarëvajtjes së menaxhimit financiar dhe kontrollit. Insitucioni nuk është shumë mirë i informuar për çështjet që mbulon MF si dhe ato që do të realizohen nga vetë stafi, për vetë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

problematikat e tjera që ka hasur vitet e fundit, të cilat janë trajtuar më hollësisht në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

+ Drejtimi 5: “*Të ndryshme*”.

Mbi kryerjen e inventarizimit të pasurisë së institucionit

Gjatë auditimit u konstatua se, në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 e tij, Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore disponon një regjistër në formë kartelash të aktiveve që ka në zotërim ky institucion. Regjistri i aktiveve i vënë në dispozicion i përmbush të gjitha kriteret e udhëzimit të sipërcituar. Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7 “Inventari I aktiveve dhe detyrimeve” të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, të ndryshuar” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit Publik” të ndryshuar, pika 81 e tij, Drejtoresha e Përgjithshme e Qendrës së Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, znj. V. R. ka urdhëruar nëpërmjet shkresës nr. 159, datë 28.12.2015 dhe nëpërmjet shkresës nr. 84 prot, datë 08.12.2016, ngritjen e komisionit me 3 anëtarë për kryerjen e inventarizimit të QTADT. Duke qenë se institucioni është i një kapaciteti të vogël, ky komision përbëhet edhe nga punonjës që kanë në dorëzim objekte, në kundërshtim me pikën 82 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku përcaktohet se “*Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi.*”

Në vijim të këtij urdhri, janë kryer verifikimet e nevojshme dhe komisioni në prezencë të personelit përgjegjës ka përgatitur listat për çdo llogari dhe për çdo nëpunës që ka në ngarkim mjetet dhe objektet inventariale. Sipas sektorit të financës, në përmbledhjen e gjendjes së aktiveve të trupëzuara në vitin 2015, kanë rezultuar aktive në shumën totale 1,257,638 lekë, nga të cilat 664,940 lekë në përdorim të punonjësve dhe 598,180 lekë inventar në magazinë; ndërsa për vitin 2016 në një total prej 1,257,638 lekë, nga të cilat është në përdorim të punonjësve totali prej 780,643 lekë dhe në inventarin e magazinës janë deklaruar një total prej 482,476 lekë. Nga komisioni nuk është përgatitur një relacion për konstatimin apo jo të diferencave nga vlera e kontabilizuar me atë që ka rezultuar faktikisht, por është konsideruar e mirëqenë saktësia në procesin e inventarizimit. Institucioni nuk ka konsideruar të nevojshëm ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të ndonjë aktivi që disponon.

Sa më poshtë gjetjet kryesore të konstatuara gjatë këtij auditimi dhe rekomandimet

Drejtimi 1: “*Auditim mbi veprimtarinë e Qendrës për Trajnimin e Administratës Tatimore dhe Doganore*”

Titulli i Gjetjes-1 Mbi aktivitetin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore

Situata: - VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” ka përcaktuar se QTATD drejtohet nga një Bord Drejtues megjithëse ky është një institucion në varësi të Ministrisë së Financave. Kjo formë organizimi nuk mbështetet në Ligjin Nr. 90/2012 datë 27.09.2012



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

“Për Organizimin dhe Funkzionimin e Administratës Shtetërore” i cili në nenin 18 përcakton se “*Institucioni i varësisë organizohet si drejtori apo drejtori e përgjithshme, në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë përkatëse. Niveli i organizimit përcaktohet në vendimin e krijimit*”. Po kështu forma e organizimit me Bord Drejtues sipas VKM nr.1264 nuk i përshtatet as formës së organizimit të një Agjencie Autonome, e cila duhet të bëhet me ligj dhe jo me VKM si në rastin konkret.

Në VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” përcaktohet se;

- “Trajnuesit e Përhershëm” sipas përcaktimit në pikën 9, nuk kryejnë veprimtari trajnuese megjithëse në emërtimin e tyre trajtohen si të tillë. Detyra e tyre e përcaktuar në VKM ekzistuese është të sigurojnë mbështetjen për organizimin e trajnimeve, monitorimin, plotësimin, dhe vlerësimin e rezultateve të trajnimit për çdo nëpunës. Emërtimi dhe detyrat e punonjësve të brendshëm të qendrës të emërtuar “*Trajnues të Përhershëm*” kërkojnë kapacitete profesionale të një niveli të lartë të cilat duhet të jenë mirëpërcaktuar në bazën ligjore, në mënyrë që të mos jenë të prekshme nga vendimmarrje të një niveli më të ulët.

- Baza rregullative parashikon edhe “Trajnuesit part-time” të cilët ndryshe nga punonjësit e përhershëm dhe punonjësit administrativë me të cilët përcaktohet lidhja e kontratës së punës sipas pikës 8/dh dhe 8/ë, pikën 10 të saj, përcaktohet termi kontraktim “*Trajnuesit e kontraktuar me kontrata part-time...*” duke i kthyer këta trajnerë në staf që duhet të deklarohen nga qendra si të punësuar dhe për të cilët duhet të derdhen edhe sigurime shoqërore, fakt që e rrit koston në nivele të paparashikuara. Ky përcaktim ka bërë që QTATD të përfshijë në procesin trajnues vetëm trajnerë të marrë nga administrata tatimore dhe doganore pjesë të administratës publike dhe që e kanë kryer këtë mision pa pagesë shtesë.

Nga ana tjetër në kriteret e përgjithshme për kontraktimin e “*Trajnuesve part-time*” sipas 10/b të VKM përcaktohet dhe rasti që këta trajnerë të jenë të punësuar në poste drejtuese në administratën publike me përvojë të paktën 5-vjeçare. Kriteret e lidhura me funksionet dhe jo kapacitetet e personave që përfshihen për trajnerë, ul nivelin e trajnimeve dhe krijon rrishtje operacionale për sa kohë vlerësimi i trajnimit ndikon në vlerësimin e punonjësve tatimor apo doganor.

- VKM nr.1264 datë 16.12.2009 përcakton se “*Punonjësit në periudhë prove, të cilët nuk kalojnë provimin e vlerësimit të organizuar pranë Akademisë, nuk konfirmohen për përfundimin me sukses të periudhës së provës*” aspekt që ka një rregullim tjetër në bazë të Ligjit 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” sipas të cilit Shkolla Shqiptare e Administratës Publik (ASPA) është institucioni që duhet të realizojë vlerësimin e nëpunësit civil për periudhën e provës pas përfundimit të ciklit të detyrueshëm të trajnimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

- Megjithëse ngarkesën më të madhe të trajnimeve të administratës tatimore dhe doganore i realizon kjo qendër, konstatohet se brenda strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka një sektor të veçantë për trajnimin e punonjësve. Duhet të theksojmë se Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore e cila në fokusin e veprimtarisë së saj ka pikërisht trajnimin e administratës fiskale, ka anëtarë të Bordit Drejtues Titullarët e këtyre 2-Drejtorive, çka tregon qartë mosfunksionimin e duhur të niveleve drejtuese të këtyre institucioneve në drejtimin e personelit, për sa kohë që konstatohen kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Kriteri :

Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”. VKM Nr. 1264 datë 16.12.2009 “*Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore*”, Ligji Nr. 90/2012 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore*”.

Ndikimi/Efekti

Për përcaktimin e kompetencave të qarta të QTATD si institucion publik varësie si dhe për qartësimin e mënyrën e funksionimit, kompetencave për testimin, vlerësimin dhe çertifikimin e punonjësve të trajnuar, rekrutimin e trajnerëve part-time dhe pagesës së tyre, etj, për të garantuar shërbim efektiv dhe eficient në trajnimin e specializuar të administratës fiskale si dhe eliminimin e kostove shtesë për buxhetin e shtetit.

Shkaku:

Funksionimi i Institucionit me një bazë ligjore e cila nuk pasqyron plotësisht misionin e qendrës por edhe mospërputhje e saj me aktet e tjera ligjore në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës publike dhe formimin profesional të punonjësve publik, si dhe përmbushje e detyrimeve prej anëtarëve të bordit për adresimin e problematikave, të cilat hasen në zbatimin e VKM Nr.1264 datë 16.12.2009.

Rëndësia

E lartë

Rekomandimi

Ministria e Financave si organ që ka në varësi këto struktura të rishikojë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtrohet aktiviteti trajnues me qëllim qartësimin dhe saktësimin e fushës së veprimtarisë së tyre si dhe harmonizimin me kuadrin e përgjithshëm ligjor në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e administratës publike dhe formimin profesional të punonjësve publikë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Drejtimi 2: “*Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, rregullshmëria e zbatimit të kuadrit ligjor në shpenzimet për paga dhe shpërblime, shpenzime operative dhe shpenzime të tjera*”

- Titulli i Gjetjes:** Shpenzimet e realizuara nga institucioni ishin dukshëm më të ulëta se planifikimi i tyre.
- Situata:** Nga auditimi i procedurave të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të Qendrës së Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore rezultoi se për periudhën objekt auditimi, shpenzimet e realizuara nga institucioni ishin dukshëm më të ulëta se planifikimi i tyre, për shkak të mungesës së koordinimit me strukturën administrative të Ministrisë së Financave për kryerjen e procedurave përkatëse për blerjen e mallrave, dhe mos plotësimit të pozicioneve vakante nga ana e Departamentit të Administratës Publike. Po kështu, konstatohet në vitin 2017, pas largimit nga puna të nënpunëses zbatuese të institucionit, ky funksion kryhet nga nënpunësi zbatues i Ministrisë së Financave.
- Kriteri:** Neni 24 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimi për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, respektivisht për vitin 2015, 2016 dhe 2017: udhëzimi nr.8 datë 27.02.2015, udhëzimi nr, 412 datë 08.07.2016.
- Ndikimi/Efekti:** Nga auditimi u konstatua se realizimi faktik i shpenzimeve të vitit 2014 ka qenë në shumën 4,787 mijë lekë dhe në PBA e vitit 2015 janë programuar 16 milion lekë shpenzime për QTADT, pra rreth 11,713 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë. Nga ky planifikim buxhetor, institucioni ka vënë në përdorim 4,257 mijë lekë, pra 11,663 mijë lekë më pak se plani. Në vitin 2016, PBA e planifikuar në dy faza dhe plani buxhetor përfundimtar ka qenë rreth 16 milion lekë, pra janë programuar rreth 11,743 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë. Nga ky planifikim buxhetor, institucioni ka vënë në përdorim 4,066 mijë lekë, pra 11,934 mijë lekë më pak se plani. Në vitin 2017 PBA në fazën e dytë dhe planifikimi buxhetor paraqitet në shumën 16,200 mijë lekë, pra rreth 12,134 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë. Nga ky plan, institucioni deri në fund të tetorit 2017 ka shpenzuar 4,330 mijë lekë, pra 11,870 mijë lekë më pak se plani. . Po kështu, konstatohet në vitin 2017, pas largimit nga puna të nënpunëses zbatuese të institucionit, ky funksion kryhet nga nënpunësi zbatues i Ministrisë së Financave.
- Shkaku:** Mungesa e koordinimit midis Qendrës së Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore dhe Ministrisë së Financave, në programimin dhe zbatimin e shpenzimeve të parashikuara.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Rëndësia: I mesëm

Rekomandime:

- Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore të marrë masa që në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të kryejnë zbatimin në afat të shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara në përputhje me aktivitetin e institucionit, për të realizuar kështu përdorimin efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit në sektorët prioritarë.
- Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave të kryejnë vlerësimin për ekzistencën e konfliktit të interesit në kryerjen e funksionit të nëpunësit zbatues për dy institucionet, përkatësisht Ministrisë së Financave dhe QTADT, si njësi vartësie e saj..

- QTATD ka paraqitur observacionin nr. 1143/3 Prot datë 19.12.2017 në të cilin trajton se problematikat e buxhetit lidhen me zbatimin e planit dhe jo me programimin e tij, kjo për shkak të moskryerjes së procedurave për blerje nga ana e Ministrisë së Financave si dhe mosplotësim të vendeve vakante nga ana e DAP.

Koment i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimet e dhëna, grupi i auditimit konstaton se subjekti QTATD nuk paraqet kundërshtime lidhur me sa trajtohet në material, ndërsa lidhur me moskoordinimin me Ministrinë e Financave është lënë rekomandimi përkatës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si **më poshtë**:

A. KONKLuzionET DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000⁴). Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁵, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet aktiviteti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Qendrën e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, janë konstatuar aspekte jofunksionale të lidhura me kuadrin ligjor rregullator të tejkaluar në kohë dhe mospërshtatjen e tij me ndryshimet që kanë ndodhur në mjedisin ku ushtron veprimtarinë kjo qendër. Është konstatuar mosfunksionimi për një kohë të gjatë i Bordit Drejtues pavarësisht përpjekjeve konstante dhe pozitive të Drejtorit të QTATD, duke penguar realizimin e plotë të qëllimit për të cilin është krijuar kjo qendër me natyrë unike. Auditimi i Përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, për shkak të mospërputhjeve të

⁴ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

⁵Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së”.

⁶ISSAI 4000 - 4200 - Audituesi shpreh një konkluzion të kualifikuar kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

konstatuara me kuadrin ligjor dhe rregullator (*kriteret*), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, konkludon me dhënien e *një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë*⁶.

Në Opinionin tonë, subjekti Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore, përveç mangësive të identifikuar që ndikojnë në nivelin e plotësimit të qëllimit të veprimtarisë së saj, ka plotësuar nevojat për trajnim të identifikuar nga administrata fiskale, tatimore dhe doganore.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përputhshmërinë e organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së QTATD me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike rezultoi se;

- VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” ka përcaktuar se QTATD drejtohet nga një Bord Drejtues megjithëse ky është një institucion në varësi të Ministrisë të Financave. Kjo formë organizimi nuk mbështetet në Ligjin Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore” i cili në nenin 18 përcakton se “*Institucioni i varësisë organizohet si drejtori apo drejtori e përgjithshme, në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë përkatëse. Niveli i organizimit përcaktohet në vendimin e krijimit*”. Po kështu forma e organizimit me Bord Drejtues sipas VKM nr.1264 nuk i përshtatet as formës së organizimit të një Agjencie Autonome, e cila duhet të bëhet me ligj dhe jo me VKM si në rastin konkret. Në VKM nr.1264 datë 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore” përcaktohet se;

- “Trajnuesit e Përhershëm” sipas përcaktimit në pikën 9, nuk kryejnë veprimtari trajnuese megjithëse në emërtimin e tyre trajtohen si të tillë. Detyra e tyre e përcaktuar në VKM ekzistuese është të sigurojnë mbështetjen për organizimin e trajnimeve, monitorimin, plotësimin, dhe vlerësimin e rezultateve të trajnimit për çdo nëpunës. Emërtimi dhe detyrat e punonjësve të brendshëm të qendrës të emërtuar “*Trajnues të Përhershëm*” kërkojnë kapacitete profesionale të një niveli të lartë të cilat duhet të jenë mirëpërcaktuar në bazën ligjore, në mënyrë që të mos jenë të prekshme nga vendimmarrje të një niveli më të ulët.

- Baza rregullative parashikon edhe “Trajnuesit part-time” të cilët ndryshe nga punonjësit e përhershëm dhe punonjësit administrativë me të cilët përcaktohet lidhja e kontratës së punës sipas pikës 8/dh dhe 8/ë, pikën 10 të saj, përcaktohet termi kontraktim “*Trajnuesit e kontraktuar me kontrata part-time...*” duke i kthyer këta trajnerë në staf që duhet të deklarohen nga qendra si të punësuar dhe për të cilët duhet të derdhen edhe sigurime shoqërore, fakt që e rrit koston në nivele të paparashikuara. Ky përcaktim ka bërë që QTATD të përfshijë në procesin trajnues vetëm trajnerë të marrë nga administrata tatimore dhe doganore pjesë të administratës publike dhe që e kanë kryer këtë mision pa pagesë shtesë.

Nga ana tjetër në kriteret e përgjithshme për kontraktimin e “*Trajnuesve part-time*” sipas 10/b të VKM përcaktohet dhe rasti që këta trajnerë të jenë të punësuar në poste drejtuese në administratën publike me përvojë të paktën 5-vjeçare. Kriteret e lidhura me funksionet dhe jo kapacitetet e personave që përfshihen për trajnerë, ul nivelin e trajnimeve dhe krijon risqe operacionale për sa kohë vlerësimi i trajnimit ndikon në vlerësimin e punonjësit tatimor apo doganor.

- VKM nr.1264 datë 16.12.2009 përcakton se “*Punonjësit në periudhe prove, të cilët nuk kalojnë provimin e vlerësimit të organizuar pranë Akademisë, nuk konfirmohen për përfundimin me sukses të periudhës së provës*” aspekt që ka një rregullim tjetër në bazë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore Dhe Doganore”

Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” sipas të cilit Shkolla Shqiptare e Administratës Publik (ASPA) është institucioni që duhet të realizojë vlerësimin e nëpunësit civil për periudhën e provës pas përfundimit të ciklit të detyrueshëm të trajnimit.

- Megjithëse ngarkesën më të madhe të trajnimeve të administratës tatimore dhe doganore i realizon kjo qendër, konstatohet se brenda strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka një sektor të veçantë për trajnimin e punonjësve. Duhet të theksojmë se Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore e cila në fokusin e veprimtarisë së saj ka pikërisht trajnimin e administratës fiskale, ka anëtarë të Bordit Drejtues Titullarët e këtyre 2-Drejtorive, çka tregon qartë mosfunksionimin e duhur të niveleve drejtuese të këtyre institucioneve në drejtimin e personelit, për sa kohë që konstatohen kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Financave si organ që ka në varësi këtë Qendër, të rishikojë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtrohen aktivitetet trajnuese me qëllim, qartësimin dhe saktësimin e fushës së veprimtarisë së tyre si dhe harmonizimin me kuadrin e përgjithshëm ligjor në fuqi.

Menjëherë

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të Qendrës së Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore rezultoi se për periudhën objekt auditimi, shpenzimet e realizuara nga institucioni ishin dukshëm më të ulëta se planifikimi i tyre, për shkak të mungesës së koordinimit me strukturën administrative të Ministrisë së Financave për kryerjen e procedurave përkatëse për blerjen e mallrave, dhe mos plotësimin të pozicioneve vakante nga ana e Departamentit të Administratës Publike. Po kështu, konstatohet në vitin 2017, pas largimit nga puna të nënpunëses zbatuese të institucionit, ky funksion kryhet nga nënpunësi zbatues i Ministrisë së Financave.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore të marrë masa që në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të kryejnë zbatimin në afat të shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara në përputhje me aktivitetin e institucionit, për të realizuar kështu përdorimin efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit në sektorët prioritarë.

1.2. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave të kryejnë vlerësimin për ekzistencën e konfliktit të interesit në kryerjen e funksionit të nëpunësit zbatues për dy institucionet, përkatësisht Ministrisë së Financave dhe QTADT, si njësi vartësie e saj.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

- 1. K. X.(Përgjegjësi i Grupit të Auditimit)**
- 2. J. T.**
- 3. E. LL.**

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. S.